

URDHËR
Nr. 313, datë 20.10.2020

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT PSIKOSOCIAL NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE PROCEDURAT E
EMËRIMIT, PEZULLIMIT DHE LARGIMIT NË SHËRBIMIN PSIKOSOCIAL**

(Ndryshuar me urdhrin nr. 358, datë 23.12.2020; nr. 414, datë 26.7.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 20 dhe të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Shërbimi psikosocial (SHPS) ofron mbështetje nëpërmjet psikologëve ose punonjësve socialë për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme, vlerësimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psikosociale, hartimin e programeve parandaluese, sipas nevojave të komunitetit shkollor.

2. SHPS-ja vlerëson gjendjen psikosociale të nxënësve me probleme të të nxënësve ose të sjelljes dhe në bashkëpunim me mësues e drejtues të institucioneve arsimore dhe prindërit, planifikon dhe realizon shërbime që ndihmojnë në zhvillimin arsimor, social dhe personal të nxënësve.

3. SHPS-ja u ofrohet nxënësve të institucioneve publike të arsimit parauniversitar dhe sigurohet nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në institucionet private të arsimit parauniversitar ky shërbim ofrohet nga vetë institucioni.

KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SHËRBIMIT PSIKOSOCIAL

1. Drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) janë përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial, në institucionet arsimore parauniversitare publike në juridiksionin e tyre.

2. Zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) në varësi të numrit të nxënësve, parashikojnë numrin e nevojshëm të psikologëve/punonjësve socialë, duke përcaktuar edhe institucionin/et arsimor/e për çdo vend të lirë në momentin e shpalljes së vendit vakant dhe i dërgojnë zyrtarisht në DRAP.

3. Njësia e shërbimit psikosocial (NJSHPS) ngrihet dhe funksionon në nivel DRAP-i dhe përbëhet nga:

- a) psikologë/punonjës socialë;
- b) drejtuesi i njësisë së shërbimit psikosocial;
- c) supervizori i psikologëve/i punonjësve socialë.

4. Numri i psikologëve/punonjësve socialë, në njësinë e shërbimit psikosocial, përcaktohet si vijon:

- a) një psikolog/punonjës social për 500–700 nxënës;
- b) dy psikologë/punonjës socialë për çdo shkollë me mbi 700 nxënës;
- c) një psikolog/punonjës social për çdo shkollë që ka të paktën 10 nxënës me aftësi të kufizuara të përcaktuar me raport të Komisionit Mjekoligjor;
- ç) një psikolog për çdo shkollë të arsimit special;
- d) një psikolog/punonjës social do të mbulojë disa shkolla në rastet kur shkollat janë me numër më të vogël se 500 nxënës.

5. Numri i punonjësve të njësisë së shërbimit psikosocial përfshihet brenda numrit të punonjësve buxhetorë të miratuar.

6. Drejtuesi i NJSHPS-së duhet të ketë të paktën 5 vite punë si psikolog/punonjës social.

7. Drejtuesi i NJSHPS-së përzgjidhet një nga anëtarët e SHPS-së dhe emërohet nga titullari i DRAP-it, pas propozimit të dy kandidatëve të përzgjedhur me votim të fshehtë nga NJSHPS-së.

8. Drejtuesi i NJSHPS-së në bashkëpunim me punonjësit e SHPS-së organizon punën vjetore të njësisë.

9. DRAP-i, në përshkrimin e punës së drejtuesit të njësisë së SHPS-së, përcakton kohën e tij në rolin e drejtuesit dhe kohën që ai do të punojë si psikolog/punonjës social në institucionet arsimore publike.

10. Për çdo 30 psikologë caktohet një supervisor i psikologut dhe për çdo 30 punonjës socialë caktohet një supervisor të punonjësit social.

11. Supervisor i psikologëve dhe supervisor i punonjësve socialë duhet të kenë të paktën 3 vite punë si psikolog/punonjës social në institucionet arsimore.

12. Supervisor propozohet nga drejtuesi i NJSHPS-së dhe miratohet nga titullari i DRAP-it.

13. Supervisor i njësisë udhëzon nga ana profesionale psikologët/punonjësit socialë në kryerjen e detyrave të tyre, i supervizon ata dhe dokumenton rregullisht çdo supervizim të kryer individualisht ose në grup, duke hartuar raporte në çdo tre muaj për drejtuesin e njësisë së shërbimit psikosocial.

14. DRAP-i, në përshkrimin e punës së supervisorit, përcakton kohën e tij në rolin e supervisorit dhe kohën që ai do të punojë si psikolog/punonjës social në institucionet arsimore publike.

KREU III

KRITERET PËR TË PUNËSUAR NË SHËRBIMIN PSIKOSOCIAL

(Ndryshuar shkronja "a" e pikës 3 me urdhrin nr. 414, datë 26.7.2023)

1. Kriteria të përgjithshme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- e) të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

2. Kërkesa të veçanta:

- a) të jetë i pajisur me diplomë të ciklit të dytë të studimeve në fushën përkatëse;
- b) të jetë i pajisur me licencë të ushtrimit të profesionit;
- c) të jetë pjesë e urdhrin përkatës;
- d) të zotërojë njohuri bazë në kompjuter;
- e) zotërimi i gjuhëve të huaja përbën avantazh (dëshmi, certifikata).

3. Psikologu/punonjësi social ka formim si vijon:

a) Psikologu duhet të ketë diplomë të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë, ose ekuivalente me to në përputhje me përcaktimet e ligjit 80/2015, dhe pas vitit 2019, licencë në fushën e psikologjisë së edukimit të lëshuar nga Urdhri i Psikologut.

b) punonjësi social duhet të ketë diplomë të ciklit të parë dhe diplomë të ciklit të dytë ose ekuivalente në fushën e punës sociale në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 80/2015.

KREU IV

PROCEDURAT E KONKURRIMIT

(Ndryshuar pika 7 me urdhrin nr. 414, datë 26.7.2023)

1. Procedura e konkurrimit, renditja e kandidatëve për psikologë/punonjës socialë, si dhe pranimi në një vend të lirë pune realizohen nëpërmjet konkurrimit të hapur.

2. Shpallja për vendet e lira të punës në NJSHPS-së bëhet nga drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe publikohet në faqen e tyre zyrtare.

3. DRAP-i, bazuar në kërkesën e ZVAP-së, bën shpalljen e vendeve të lira të punës për psikologë/punonjës socialë, që krijohen në institucionet arsimore në juridiksionin e tij.

4. DRAP-i është përgjegjës për të gjitha procedurat e organizimit dhe administrimit të procedurave të konkurrimit, për vendet vakante në njësitë e SHPS-së.

5. Kandidatët që dëshirojnë të kryejnë profesionin e psikologut/punonjësit social, pas publikimit të vendeve të lira të punës për psikologë/punonjës socialë, dërgojnë me postë në adresën e DRAP-it përkatës, dokumentacionin e kërkuar në shtojcën 1, të këtij urdhri.

6. Procesi i konkurrimit për psikologë/punonjës socialë në SHPS-në realizohet në tri faza:

- a) vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur në dosje;
- b) testimi me shkrim për vlerësimin e njohurive të profesionit dhe për njohuritë mbi legjislacionin që lidhet me ushtrimin e profesionit;
- c) intervista e strukturuar.

7. Për realizimin e procedurave të konkurrimit dhe të shpalljes së listës të kandidatëve fitues, DRAP-i përkatës krijon një komision ad-hoc, i cili përbëhet nga 2 (dy) përfaqësues nga MAS-i, nga 1 (një) përfaqësues nga DPAP-ja, 1 (një) përfaqësues nga njëra prej ZVAP-ve, 1 (një) përfaqësues nga DRAP-i.

8. Komisioni *ad-hoc* shqyrton dhe vlerëson dosjet e kandidatëve sipas shtojcës 2 të këtij urdhri.

9. DRAP-i është përgjegjës për njoftimin e kandidatëve për datën, orën, mjedisin ku do të zhvillohet testimi, si dhe për caktimin e administratorëve për testimin me shkrim.

10. DRAP-i përcakton datën, orën dhe vendin e intervistës së strukturuar si dhe bën njoftimin e kandidatëve dhe anëtarëve të komisionit *ad-hoc*.

11. Drejtori i DRAP-it vë në dispozicion të komisionit *ad-hoc*, listën e kandidatëve me pikët e vlerësimit të dosjeve, pikët e testimit, si dhe pikët e tyre totale.

12. Komisioni *ad-hoc* realizon intervistën e strukturuar me kandidatët që janë kualifikuar nga testi me shkrim. Kandidatët duhet të vlerësohen me të paktën 50% të pikëve të testit me shkrim për t'u kualifikuar për në fazën e intervistës së strukturuar.

13. Në përfundim të intervistës, komisioni *ad-hoc* shpall listën e kandidatëve për psikologë dhe listën e kandidatëve për punonjës social në nivel DRAP-i, të renditur sipas pikëve gjithsej (pikë të dosjes + pikë të testimit + pikët e intervistës). Lista me rezultatet përfundimtare, i dorëzohet drejtorit të DRAP-it, i cili e publikon me ID përkatëse në faqen zyrtare të institucionit.

14. Anëtarët e komisionit *ad-hoc* dhe administratorët e provimit duhet të plotësojnë deklaratën e konfliktit të interesit sipas shtojcës 6 të këtij urdhri.

KREU IV/1

(Shtuar me urdhrin nr. 414, datë 26.7.2023)

1. Në përfundim të vitit shkollor procedurat e lëvizjes paralele administrohen nga DRAP-ja, për punonjësit e SHPS që ushtrojnë profesionin në institucionet arsimore publike parauniversitare, brenda juridiksionit të zyrave vendore të arsimit parauniversitar.

2. Punonjësi i SHPS që dëshiron të kryejë lëvizje paralele në përfundim të vitit shkollor, dërgon me postë në DRAP kërkesën për lëvizje paralele.

3. Dorëzimi i dosjeve për lëvizje paralele bëhet sipas afateve të përcaktuara nga DPAP-ja.

4. DRAP-ja krijon komisionin e vlerësimit të dosjeve për lëvizje paralele, me këtë përbërje:

- a) drejtuesi i DRAP-së (kryetar);
- b) një specialist i kurrikulës dhe zhvillimit profesional në DRAP (anëtar);
- c) juristi i DRAP-së (anëtar).

5. Komisioni i vlerësimit të dosjeve në DRAP bën vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për lëvizje paralele sipas shtojcës nr. 2 të urdhrit, brenda muajit korrik.

6. Komisioni i vlerësimit të dosjeve shpall renditjen e konkurrentëve për lëvizje paralele sipas zyrave vendore dhe pikëve në rendin zbritës. Lista me renditjen e punonjësve të SHPS-së shpallet në faqen elektronike zyrtare të DRAP-së, e cila dërgon një kopje të listës në DPAP.

7. Punonjësi i renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendin e lirë të punës brenda ZVAP-së ku ka emërimin e përhershëm. Ai dërgon brenda 24 orëve me e-mail

konfirmimin ose refuzimin e vendit të propozuar. Në rast të mos konfirmimit nga kandidati, ky vend pune i ofrohet punonjësit të listuar një rend më poshtë.

8. Pas përzgjedhjes së vendit të punës nga kandidati, DRAP-i përkatës nxjerr aktin e emërimit të kandidatit në institucionin arsimor parauniversitar të përzgjedhur prej tij dhe nënshkruan kontratën e punës me të.

KREU V

PROCEDURAT E EMËRIMIT

(Ndryshuar pikat 3, 5 dhe 6 me urdhrin nr. 358, datë 23.12.2020)

1. Titullari i DRAP-it, bazuar në renditjen përfundimtare të kandidatëve për psikologë/punonjës socialë, të dorëzuar nga komisioni *ad-hoc*, iu ofron kandidatëve vendet e lira të punës me të drejtë përzgjedhjeje sipas renditjes, duke filluar nga kandidati i renditur i pari.

2. Kandidati pasi njoftohet përzgjedh vendin e punës dhe nuk mund të refuzojë më shumë se tri vende të lira pune.

3. Pas përzgjedhjes së vendit të punës nga kandidati, DRAP-i përkatës nxjerr aktin e emërimit të kandidatit në institucionin arsimor parauniversitar të përzgjedhur prej tij dhe nënshkruan kontratën e punës me të.

...

4. Kandidati punësohet me kontratë pune individuale, me ose pa afat, sipas kërkesave të vendit të lirë të punës, bazuar në legjislacionin në fuqi.

5. Në rastet kur vendi i punës është formuar nga më shumë se 1 (një) institucion arsimor parauniversitar, DRAP-i përkatës nxjerr aktin e emërimit dhe nënshkruan kontratën e punës, sipas institucioneve arsimore parauniversitare të përcaktuara nga ZVAP-ja për vendin e punës, në varësi të numrit të nxënësve. Punonjësi i Shërbimit Psikosocial evidentohet në listëprezencën e institucionit arsimor parauniversitar publik me numrin më të madh të nxënësve.

6. Kandidati fitues paraqitet në institucionin arsimor parauniversitar publik, brenda 3 ditëve pune, nga data që ka përzgjedhur dhe ka nënshkruar kontratën e punës me DRAP-in përkatës. Nëse për arsye të ligjshme kandidati nuk mund të paraqitet në institucion për të filluar marrëdhëniet e punës, duhet të njoftojë drejtorin e DRAP-it përkatës, për shkakun e mosparaqitjes dhe të kërkojë zgjatjen e afatit të paraqitjes në institucion.

7. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit për të gjitha procedurat e përcaktuara në këtë urdhër sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VI

PROCEDURAT E PEZULLIMIT DHE LARGIMIT NGA PUNA

(Ndryshuar pika 1 me urdhrin nr. 358, datë 23.12.2020)

1. Me propozim të drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar publik, drejtori i DRAP-it merr masën e pezullimit ndaj psikologut/punonjësit social, në rastet kur:

a) gjykata vendos ndaj tij, masë të sigurimit personal deri në vendimin e formës së prerë;
b) ka nisur procedura disiplinore dhe vlerësohet se qëndrimi i tij në punë përbën rrezik të zhdukë, të vështirësujë, të manipulujë ose të bëjë të pamundur marrjen e provave që lidhen me procedurën disiplinore.

2. Psikologut/punonjësit social të pezulluar i ndërpriten marrëdhëniet financiare për kohën e pezullimit.

3. Largimi nga puna i psikologut/punonjësit social bëhet nga drejtori i DRAP-it, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Procedura për largim nga puna, fillon në bazë të propozimit me shkrim të drejtuesit/ve të institucionit/eve arsimor/e parauniversitare publik/e ose bazuar në raportet e inspektimit, në të cilët rekomandohet largimi nga detyra i psikologut/punonjësit social.

KREU VII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Procedurat e ndjekura, dokumentet e administruara dhe vendimet e marra për zbatimin e këtij urdhri ruhen në DRAP-in përkatës, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, në bashkëpunim me zyrat vendore të arsimit parauniversitar, marrin masa për riorganizimin e SHPS-së, sipas përcaktimeve të këtij urdhri.

3. Kriteret e veçanta të përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 2, të kreut III, të këtij urdhri, do të zbatohen për profesionet e rregulluara, për të cilat ofrohet pajisja me licencën përkatëse të kandidatëve dhe për profesionin për të cilin është krijuar urdhri përkatës.

4. DRAP-i, në vendet e punës që mbeten të paplotësuara, si rrjedhojë e mungesës së kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë urdhër, mund të punësojë me kontratë pune me afat, deri në përfundim të vitit shkollor, kandidatë që kanë bërë kërkesë në DRAP sipas një thirrjeje të veçantë dhe që kanë kryer të paktën studime të ciklit të parë të studimeve në fushën e psikologut/punonjësit social, pasi ka vlerësuar dhe renditur dosjet e secilit prej kandidatëve.

5. Urdhri nr. 344, datë 19.8.2013, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për ngritjen e njësisë së shërbimit psikosocial”, i ndryshuar, shfuqizohet.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Evis Kushi

SHTOJCË 1
DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PËRMBAJË DOSJA PËR KONKURRIM

- a) Jetëshkrimi sipas shtojcës 3 të këtij urdhri.
- b) Kërkesë për pjesëmarrjen në konkurrimin për pozicionin psikolog/ punonjës social.
- c) Raport mjekoligjor i tre muajve të fundit.
- d) Deklaratë për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati sipas shtojcës 4, të këtij urdhri.
- e) Formular vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore sipas shtojcës 5 të këtij urdhri.
- f) Fotokopje e librezës së punës e noterizuar (nëse ka).
- g) Kopje e njëzuar me origjinalin e diplomës/diplomave, vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta (cikli i parë, cikli i dytë dhe diplomat e integruara të ciklit të dytë) ose të barasvlershme me këto, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
- h) Kopje e njëzuar me origjinalin e diplomës dhe listës së notave të arsimit shtesë ose të studimeve të doktorturës (nëse ka).
- i) Kopje të njëzuar me origjinalin të licencës për ushtrimin e profesionit. Ky dokument do të dorëzohet për profesionet e rregulluara, për të cilat ofrohet pajisja me licencën përkatëse.
- j) Dëshmi të gjuhës/gjuhëve të huaja të mbrojtura (nëse ka).
- k) Certifikatë personale e tre muajve të fundit.

SHTOJCË 2
TABELA E PIKËVE TË DOSJES, TESTIMIT, INTERVISTËS

1	Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II)/2 ose nota mesatare DIND. Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: Nota mesatare 5.00 - 6.00 = 2 pikë Nota mesatare 6.01 - 7.00 = 4 pikë Nota mesatare 7.01 - 8.00 = 6 pikë Nota mesatare 8.01 - 9.00 = 8 pikë Nota mesatare 9.01 - 10.00 = 10 pikë	10 pikë
2	Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja: a) gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 1 pikë. b) gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 = 2 pikë. Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë se 2 pikë në vlerësimin e dosjes.	0–2 pikë
3	Vjetërsia në punë Pikët sipas kësaj rubrike llogariten nga shumëzimi i viteve të punës me vlerën 0.5. Vite pune për efekt të vlerësimit të dosjes, do të vlerësohen deri në 20 vite pune. Kandidatët me mbi 20 vite pune vlerësohen me 10 pikë.	0–10 pikë
5	Studime të ciklit të tretë të studimeve, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, të kryera në fushën për të cilën konkurron. (Master ekzekutiv ose ekuivalente me të/doktoraturë)	3 pikë
6	Testimi me shkrim ka 40 pyetje me alternativa. Çdo pyetje vlerësohet me 1 pikë.	40 pikë
7	Intervista e strukturuar	0–35 pikë
	SHUMA E PIKËVE	100 pikë

Fushat e njohurive, formati i testit me shkrim dhe intervistës së strukturuar përcaktohen në shpalljen përkatëse për rekrutim.

SHTOJCË 3
JETËSHKRIMI

- I. EMRI, MBIEMRI
- II. DATËLINDJA
- III. TELEFONI
- IV. ARSIMI
- V. CERTIFIKATA
- VI. PUNËSIMI

Dëshmoj se i kam kuptuar urdhrat për plotësimin e shtojcës 3 dhe pasojat nga plotësimi i pasaktë i saj.

Nënshkrimi

Data _____

SHTOJCË 4
DEKLARATË PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË
PARAQITURA NGA KANDIDATI

Unë..... kandidat në procesin e konkurrimit për psikolog/punonjës social në DRAP, deklaroj në përgjegjësinë time se dokumentacioni i paraqitur nga ana ime për konkurrim është i vërtetë. Autorizoj DRAP-in të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

KANDIDATI

SHTOJCË 5
FORMULARI I VETËDEKLARIMIT TË GJENDJES GJYQËSORE

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Emri mbiemri	
Atësia/amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (numri) (një kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj, me vullnetin tim të lirë, se jam: ☐ i/e padënuar ☐ i/e dënuar

DEKLARUESI

MARRËSI I VETËDEKLARIMIT

emër mbiemër / firmë

emër mbiemër / firmë / vulë

Autorizim. Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga DRAP/ZVAP.

Subjekti i autorizuar

Nënshkrimi i deklaruesit autorizues

Data e nënshkrimit

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi sipas legjislacionit në fuqi dhe sjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

SHTOJCË 6
FORMULAR DEKLARIMI PËR KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklaruesi: Z./Znj. _____

Pozicioni aktual i punës: _____

Vendi i punës: _____

Unë nënshkruesi _____

(emër, atësia, mbiemër)

Anëtar i komisionit *ad-hoc*/administrator për testimin me shkrim, në konkurrimin për punonjës të shërbimit psikosocial në DRAP _____,

Deklaroj, nën përgjegjësinë time të plotë, se _____ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon legjislacioni në fuqi për konfliktin e interesave.

Kandidat për punonjës në shërbimin psikosocial në institucionit publik të arsimit parauniversitar; _____

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklarimit.

Datë _____._____._____

Nënshkruesi _____

(emër, mbiemër, firmë)